REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

Sekretaria

Nr. 267 Prot. Tiranë më 22.07.2022

**PROCESVERBAL**

**Mbledhje e Bordit Mbikqyrës të AMShC-së**

Sot, në datën 22.07.2022 në orën 13:00, në ambientet e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile ( AMSHC ) u mbajt mbledhja e radhës e Bordit Mbikqyrës të AMSHC-së.

Rendi i ditës, sipas njoftimit paraprak të Kryetarit të Bordit ishte:

1 - Propozimi dhe Votimi për Nënkryetarin e Bordit Mbikqyrës të AMSHC-së.

2 - Plotësimi i formularit të deklarimit nga Kryetarja, Nënkryetari dhe Anëtarët e Bordit për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike.

3 - Lista e aplikimeve për Thirrjen-15

4 - Shpallja e Listës së OJF-ve fituese dhe jo-fituese për Thirrjen-15

5 – Buxheti në dispozicion për realizimin e projekteve

6 – Mënyra e njoftimit të OJF-ve fituese dhe jofituese

Të pranishëm në mbledhje ishin anëtarët e Bordit Mbikqyrës të AMSHC-së:

1. Znj. Iris Luarasi – Kryetare
2. Znj. Vasilika Hysi – Anëtare
3. Znj. Eridana Cano - Anëtare
4. Z. Besmir Gjokutaj – Anëtar
5. Z. Bashkim Muça – Anëtar
6. Z. Leart Kola – Anëtar
7. Z. Oltjon Muzaka – Anëtar

Të pranishëm nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile:

1. Z. Andi Kananaj – Drejtor Ekzekutiv
2. Znj. Orjentila Paluca – Sekretare



Adresa: Rr. "Frosina Plaku" Nr. 58, Kati II, Tiranë, Shqipëri.
Telefon: 042235569 website: www.amshc.gov.al E-mail: info@amshc.gov.al

Fjalën e hapjes e mori Z. Andi Kananaj – Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, i cili paraqiti një kornizë të aktiviteteve kryesore të Agjencisë si edhe rendin e ditës për diskutim. Z.Kananaj prezantoi gjithashtu antëtarët e rinj të Bordit,të cilët sipas Vendimit te keshillit te Ministrave VKM Nr. 335 dtae 26.05.2022"Për emërimin në detyrë të disa anëtarëve të bordit mbikëqyrës të agjencisë për mbështetjen e shoqërisë civile janë emëruar për të mbikqyrur aktivitetin e AMSHC-së" si dhe VKM-se Nr. 464 date 06.07.2022 si dhe në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 8, të ligjit nr.10 093, datë 9.3.2009, "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile"

Më pas Z.Kananaj kërkoi nisjen e procedurës për përzgjedhjen e Nënkrytetarit të Bordit Mbikqyrës të AMSHC-së.

Fjalën e mori Z.Oltjon Muzaka, i cili propozoi në këtë pozicion Znj. Eridana Cano.

Të gjithë të pranishmit në mbledhje votuan unanimisht pro zgjedhjes së Znj. Eridana Cano si Nënkryetare Bordi.

Pas votimit të pozicionit të N/Kryetares, Kryetarja e Bordit, Nënkryetarja dhe Anëtarët e Bordit plotësuan Formularin e Deklarimit për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në ushtrimin e funksioneve publike. Disa prej të pranishmëve ju kërkua largimi nga procesi i diskutimit, vlerësimit dhe votimit të Subjekteve të caktuara sepse ndodhen në kushtet e konfliktit te interesit.

Më pas gjatë mbledhjes fjalën e mori Znj. Vasilika Hysi, e cila hapi diskutimin në lidhje me procesin dhe numrin e aplikimeve në thirrjen-15.

Z. Kananaj bëri me dije anëtarët e pranishëm se numri total i Organizatave të cilat kanë aplikuar nga e gjithë Shqipëria për thirrjen 15-të është 161 (njëqindegjashtëdhjetëenjë). Nga këto 5 (pesë) prej tyre kanë aplikuar jashtë afatit kohor dhe 40 (dyzet) aplikime kanë qenë me mungesë apo parregullsi dokumentacioni, për rrjedhojë grupi i komisionit të vlerësimit i skualifikoi në mënyrë të menjëhershme. Komisioni i vlerësimit është i përbërë nga punonjësit e AMSHC-së dhe është përgjegjës për mbarëvajtjen e procesit të vlerësimit të projekteve.

Pas prezantimit të procesit të aplikimeve për thirrjen 15, Z.Kananaj sugjeroi që në kushtet e mosfunksionimit të adresave zyrtare të institucioneve shqiptare, lajmërimi i organizatave për rezultatin e vlerësimit dhe votimit nga Bordi të kryhet me anë të postës shqiptare. Ky propozim u kalua ne votim dhe u votua njëzëri.

Pas këtij votimi, përpara Bordit Mbikqyrës, u paraqitën për shqyrtim dhe votim vlerësimet e realizuara nga grupi i punës i ngritur nga AMSHC, në lidhje me projekt-propozimet e thirrjes-15. Pas prezantimit të listës së projekteve fituese dhe kritereve të përzgjedhjes (gjithashtu edhe vlerësimit me pikë) për secilin projekt, u vendos që lista fituese të publikohet edhe online në faqen zyrtare të AMSHC-së.



Adresa: Rr. "Frosina Plaku" Nr. 58, Kati II, Tiranë, Shqipëri.
Telefon: 042235569 website: www.amshc.gov.al E-mail: info@amshc.gov.al

Anëtarët e Bordit Mbikqyrës të AMSHC-së të pranishëm në këtë mbledhje, ranë dakord për pikat e diskutuara duke vlerësuar projekt pas projekti për pikëzimin sipas vlerësimit.

Gjatë vlerësimit dhe votimit për të shmangur konfliktin e interesit:

Znj. Iris Luarasi u largua nga votimi i Subjektit – Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza

Znj. Eridana Cano u largua nga votimi i Subjektit – Instituti per Kontratën Shoqërore

Z. Besmir Gjokutaj u largua nga votimi i Subjektit – Qendra Kombtare për Shërbime Komunitare

Z. Bashkim Muça u largua nga votimi i Subjektit - IBRI

Bashkalidhur lista e firmosur e Anëtareve të Bordit të pranishëm, si edhe lista me projekt-propozimeve fituese për Thirrjen Nr.15.

Si përfundim u vendos:

- Shpallja e listës me projektet fituese (bashkangjitur këtij procesverbali);
- Zgjedhja e Nënkryetares së Bordit Mbikqyrës të AMSHC-së;
- Kohëzgjatja dhe Shumat e financuara të panegociushme;
- Skema e financimit 70%;20%;10%;

Mbledhja u mbyll rreth orës 15:30.

Mbajti procesverbalin:

Orjentila Paluca - Sekretare



Adresa: Rr. "Frosina Plaku" Nr. 58, Kati II, Tiranë, Shqipëri.
Telefon: 042235569 website: www.amshc.gov.al E-mail: info@amshc.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE
BORDI MBIKQYRËS

Nr. 267/1 Prot.                                                                 Tiranë, më 22.07.2022

**VENDIM**

**Nr. 2 Datë 22.07.2022**

Bazuar në Ligjin Nr. 10 093 datë 09.03.2009 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile"; V. K. M- së Nr. 769, dt. 15.07.2009 "Për Miratimin e Statutit të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile" (I Ndryshuar) dhe Rregullores "Mbi Proçedurat e Financimit me Grante", Bordi Mbikqyrës i Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile:

**VENDOSI:**

1. Përcaktimin përfundimtar të listës me ogranizatat fituese të Thirrjes Nr. 15;
2. Caktimin si Nënkryetare të Bordit Mbikqyrës të AMSHC-së, Znj. Eridana Cano;
3. Skema e Financimit për projektet fituese është 70%; 20%; 10%;
4. Kohëzgjatjen dhe shumat e financimit të panegociushme;
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Për Bordin ranë dakord Kryetari dhe anëtarët si më poshtë:



Adresa: Rr. "Frosina Plaku" Nr. 58, Kati II, Tiranë, Shqipëri.
Telefon: 042235569 Website: www.amshc.gov.al E-mail: info@amshc.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPERISË
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

Për Bordin Mbikqyrës AMSHC-së:

**Iris LUARASI**
Kryetare e Bordit Mbikqyrës

**Vasilika HYSI**
Anëtare

**Eridana ÇANO**
Anëtare

**Besmir GJOKUTAJ**
Anëtar

**Bashkim MUCA**
Anëtar

**Leart KOLA**
Anëtar

**Oltjon MUZAKA**
Anëtar

**Elira KOKANA**
Anëtare

**Ylljet ALICKA**
Anëtar

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

Lista e projekteve fituese Thirrja Nr.15(31 Maj-01 Korrik 2022)

| Nr | Nr. Dosjes | Emri i OJF-së | Titulli i Projektit | Programi ku aplikohet | Shtrirja projektit | Kohezgjatja (muaj) | Shuma e Akorduar nga Bordi Mbikyrës i AMSHC-së (në lekë) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 1 | Qendra Per Ndihme Rehabilitim dhe Integrim | Sensibilizimi i komunitetit te Bashkise Vlore per nje mjedis me te paster dhe te shendetshem | 3 | Vlore | 6 | 1,800,000 |
| 2 | 2 | Instituti I Studimeve Publike dhe Ligjore | Monitorimi i zbatimit të ligjit për ndihmën juridike në kuadër të ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dytësore | 2 | Tiranë | 7 | 1,700,000 |
| 3 | 3 | Instituti i Bashkëpunimit Rajonal për Integrim - IBRI | Sensibilizimi dhe edukimi i të rinjve të rajonit Kukës mbi të drejtat e tyre | 1 | Kukës | 6 | 1,800,000 |
| 4 | 6 | PERDORUESIT E PYJEVE DHE KULLOTAVE"BRANESHI" | MBROJTJA E MJEDISIT,QELLIMI YNE I PERBASHKET | 3 | Bashkia Elbasan,fshati Branesh(Funar) | 8 | 1,000,000 |
| 5 | 8 | Qendra "Drriare" | "Kur të rritem do të bëhem Skënderbeu! Kur të rritem do të bëhem Nënë Tereza" | 3 | Tiranë, Krujë | 8 | 1,700,000 |
| 6 | 9 | Qendra per Transparence dhe Informim te Lire | Lufta kunder korrupsionit dhe rritja e transparences ne shfrytezimit te burimeve natyrore permes zbatimit te ligjit te rregjistrit te pronareve perfitues | 2 | Fier, Patos, Roskovec, Bulqize, Mirdite, Kukes, Tropje etj | 8 | 1,200,000 |
| 7 | 11 | Qendra Youth Rise | Te rinjte si force kryesore advokuese ne korce | 4 | Korce | 6 | 1,100,000 |
| 8 | 14 | Qendra për Formim dhe Zhvillim (QFZH/CFD) | Drejtësia Penale për të MituritEdukim ligjor dhe Edukim përmes Artit për forcimin e Identitetit qytetar të të miturve | 2 | Qarku Elbasan<br>Bashkia Cërrik, Bashkia Gramsh, Bashkia Librazhd | 6 | 1,300,000 |
| 9 | 15 | Instituti Shqiptar për Çështjet Publike | Për një Mjedis dhe Zhvillim të qëndrueshëm: Mendo SAFE - Organizo SAFE - Vepro SAFE | 3 | Tirane | 9 | 1,700,000 |
| 10 | 19 | Shoqata "The Bridge" (Ura) | BRIDGE FORUM 2 – panele online | 3,4 | Shqipëri, Ballkani Perëndimor dhe më gjerë | 6 | 1,000,000 |
| 11 | 23 | Qendra Expertise Albania Institute | Te rinjte, Faktor te rendesishem per mbrojtjen e mjedisit | 3 | Elbasan | 6 | 1,800,000 |
| 12 | 27 | RED-Research, Evaluation and Development | Pjesëmarrja aktive e të rinjve në nivel lokal për t'i dhënë zë nevojave dhe prioriteteve të tyre | 4 | Bashkia Elbasan, Bashkia Korçë | 6 | 1,700,000 |
| 13 | 28 | Instituti per Kerkime dhe Konsulenca | Nxitja e modeleve te reja te zhvillimit vendor | 3 | Bashkia Maliq | 6 | 1,800,000 |
| 14 | 30 | Qendra per Iniciativa Rajonale | Ndërgjegjësim rreth situatës post-COVID | 1 | Bashkia Sarande | 6 | 1,800,000 |
| 15 | 34 | Ress Egnatia | Trashegimia kulturore dhe artistike nje potencial i zhvillimit te qendrueshem | 3 | Bashkia Lushnje & Belsh | 6 | 1,800,000 |
| 16 | 35 | Aleanca Sociale | Informim dhe asistence mbi sherbimet psiko-sociale vullnetare per personat me aftesi ndryshe | 1 | Bashkia Gramsh dhe Bashkia Maliq | 6 | 1,800,000 |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 17 | 38 | Qendra "Zhvillim, Integrim,Prosperitet, Albania" | Promovimet turistike, në shërbim të mbrojtjes dhe ruajtjes së trashëgimisë kulturo | 3 | Vlorë - Sarandë | 8 | 1,800,000 |
| 18 | 39 | Instituti për Kontratën Shoqërore (SCI) | Rajoni dhe BE-ja në Shtëpinë Tonë' - Përfshirja e të rinjve beratas në proceset e integrimit rajonal dhe në BE | 4 | Qarku Berat, i cili përfshin 5 bashki (Berat, Poliçan, Çorovodë, Kuçovë dhe Dimal) dhe 20 komuna | 10 | 1,800,000 |
| 19 | 40 | Qendra e Studimeve dhe Zhvillimeve (QSZH) | "Libri – E Ardhme e Bukur për Ruajtjen e vlerave Kulturore dhe Artistike të vendit tim." | 3 | Tiranë | 9 | 1,400,000 |
| 20 | 43 | Qendra për Zhvillim Komunitar | Rritja e kapaciteve te shoqerise civile | 4 | Bashkia Himare | 6 | 1,800,000 |
| 21 | 47 | Aleanca per Qytetaret dhe Komunitet | Te rinjte i thone jo korrupsionit | 2 | Bashkia Bulqize | 6 | 1,800,000 |
| 22 | 48 | Shoqata per Intergim dhe Zhvillim | Informimi dhe sensibilizimi i te rinjve ne zonat rurale per te drejtat e tyre. | 1 | Bashkia Tropoje | 6 | 1,200,000 |
| 23 | 49 | Qendra Kombetare e Levizjes Ambientaliste | Te perdorim bimet medicinale pa demtuar biodiversitetin | 3 | Bashkia Kolonje | 6 | 1,800,000 |
| 24 | 51 | Qendra Konkret | Një hap drejt traditës | 3 | Tiranë | 6 | 1,200,000 |
| 25 | 54 | Qendra Shqiptare per Zhvillimin e Qendrueshem | Nxitja e vullnetarizmit Rinor | 3 | Bashkia Konispol | 6 | 1,800,000 |
| 26 | 56 | The DRIN FOUNDATION FONDACIONI DRIN | Promovimi i agroturizmit,turizmit kurativ (benjat) dhe atij malor si aktivitete qe ndihmojne ne zhvillimin e qendrueshem ekonomik dhe mjedisor. | 3 | Dibër | 6 | 1,600,000 |
| 27 | 57 | QENDRA PËR MBROJTJEN FORMIMIN E TRAJNIMIN PROFESIONAL TË GAZETARËVE | Rëndësia e informimit profesional mediatik gjatë krizave natyrore dhe shëndetësore | 3 | Tiranë | 10 | 1,300,000 |
| 28 | 61 | Qendra "Shtëpia e Kuqe" | Edhe unë e shoh jetën si ty! | 1 | Tiranë | 6 | 1,800,000 |
| 29 | 63 | Qendra e Medias "Verifikoj" | Dalloje rrenën-II | 4 | 12 Qarqet e vendit | 4 | 500,000 |
| 30 | 65 | FONDACIONI "ARTE" | Arti i Kujtesës: Refleksion mbi Gratë në Totalitarizëm | 3, 4 | Tiranë, Durrës, Shkodër, Korçë, Elbasan | 7 | 2,000,000 |
| 31 | 67 | Qëndra Kombëtare për Shërbime Komunitare | "Të sigurojmë një jetë cilësore për të moshuarit që jetojnë në vetmi." | 1 | Tiranë | 12 | 1,800,000 |
| 32 | 68 | Qendra Mbështetje,Informacion,Kujdes,Edukim | Kujdesi në lagjen time | 1 | Tiranë | 5 | 1,100,000 |
| 33 | 69 | Shoqata Act Now Albania | Nxitja e praktikave te qeverisjes se mire ne Bashkine e Fierit' | 4 | Bashkia Fier | 6 | 1,700,000 |
| 34 | 72 | Instituti per Integrim EVROPIAN | Informim rreth perdorimit te fondeve publike | 2 | Permet | 6 | 1,800,000 |
| 35 | 73 | Qendra Youthful | Rini aktive! | 4 | Bashkia Korçe | 6 | 1,700,000 |
| 36 | 74 | DATOA | Pjesmarrja qytetare ne mbrojtjen e mjedisit | 3 | Kolonje | 6 | 1,500,000 |
| 37 | 75 | Master Thinker Institute | Rinia Shqiptare dhe Politikat Rinore të BE | 4 | Tiranë | 6 | 1,000,000 |
| 38 | 78 | Shoqata Kombëtare Edukim për Jetën - SHKEJ | Fuqizimi i komunitetit nëpërmjet ndërhyrjeve komunitare multidisiplinare | 1 | Njësia Administrative nr.11 Bashkia Tiranë, Bashkia Kamëz | 6 | 1,300,000 |
| 39 | 86 | Instituti Shqiptar per Studime Ligjore dhe Territoriale- Qendra ALTRI | Vlerësimi dhe forcimi i kapaciteteve në burime njerëzore të Njesive të Qeverisjes Vendore në drejtim të ofrimit të Edukimit Ligjor të Publikut' | 2 | Shkodër, Lezhë, Durrës, Berat dhe Gjirokastër | 10 | 1,600,000 |
| 40 | 87 | Qendra per Studim & Trainim "Illuminatos" | Youth Ambassadors | 2 | Tiranë | 6 | 1,800,000 |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 41 | 88 | Qendra e Këshillimit dhe Shërbimeve Psikologjike | Mbeshtetje psikologjike online Post Covid 19 | 1 | Qarku Shkodër | 5 | 800,000 |
| 42 | 91 | Qendra URA | Fëmijët dhe Rinia – Rewind Memory | 3 | Tiranë | 6 | 1,800,000 |
| 43 | 92 | Shoqata LIBURNETIK | Ndermjetesimi nderkulturor dhe roli I ndermjetesit gjate procesit te integrimit social- Edicioni II | 1,4 | Shtrirje Kombëtare | 7 | 1,500,000 |
| 44 | 93 | Qendra Impuls | Projekti i gjelbër | 3 | Tiranë | 6 | 1,800,000 |
| 45 | 94 | Qendra Orbis | Rrjetet sociale dhe media e rreme | 4 | Tiranë | 6 | 1,800,000 |
| 46 | 96 | Institute for Policy and Law | Integrimi Ekonomik në Ballkanin Perëndimor | 4 | Shqipëri, Kosovë, Maqedoni e Veriut, Serbi | 6 | 1,800,000 |
| 47 | 99 | Qendra "The Good Psychology" | "Të rinjtë i thonë Stop gjuhës së urrejtjes, duke promovuar vlerat e perbashketa Evropiane" | 4 | Kukës | 5 | 700,000 |
| 48 | 102 | Qendra e Zhvillimit Shqiptar | Permiresimi i mjedisit mundesues te shoqerise | 4 | Polican | 6 | 1,800,000 |
| 49 | 105 | Akademia e Integrimit Europian dhe Negociatave | Akademia e 4 Lirive të Tregut | 4 | Shqipëri | 6 | 1,800,000 |
| 50 | 106 | QENDRA " AURA" | Edukimi ligjor dhe demokracia direkte si mjet për aktivizimin shoqërisë ( fëmijë – student – i rritur) në vendimmarrjen publike | 2 | Tiranë, Durrës, Shkodër | 6 | 800,000 |
| 51 | 113 | Shoqata Vizion i Ri 2016 (New Vision 2016) | Sipërmarrësit e rinj | 4 | Tiranë, Vorë | 6 | 1,800,000 |
| 52 | 114 | Albanian Council on Problem Gambling - ACPG | Youth addictions | 1 | Tiranë | 7 | 1,800,000 |
| 53 | 118 | Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza | Mbështetje psiko-sociale dhe ligjore për viktimat e dhunës në familje dhe individë të grupeve të margjinalizuara: përgjigje ndaj situatës post COVID-19 | 1 | Shtrirje kombëtare me fokus në Tiranë, Shijak, Rrogozhinë, Bulqizë | 8 | 1,800,000 |
| 54 | 132 | Shoqata DEV4all | Shoqeria civile aktive dhe Rinia! | 1 | Fier | 6 | 1,700,000 |
| 55 | 135 | Instituti Shqiptar i SME-ve "SME Albania" | Tirana SME Week 2022 | 4 | Kombëtar dhe Rajonal | 6 | 1,200,000 |
| 56 | 137 | Shoqata AlbNatyra | Mbrojtja e kullotave alpine dhe zhvillimi i qëndrueshëm pastorial në parkun kombëtar Shebenik | 3 | Parku Kombëtar Shebenik | 8 | 1,300,000 |
| 57 | 139 | OrArt | Rrugetim I ndryshem I njejti destinacion | 1,3 | Sarande, Shkoder, Tirane | 4 | 800,000 |
| 58 | 144 | Qendra ne Mbeshtetje te medias | Pabarazia Gjinore nepermjet nje lenteje rinore | 1 | Tirane | 8 | 1,300,000 |
| 59 | 145 | Qendra Bej Dicka | Të rinjtë, miqtë e mjedisit | 3 | Tiranë | 7 | 1,800,000 |
| 60 | 148 | INTBAU Albania - The International Network for Traditional Building, Architecture & Urbanism | Tirana ecën vetë: Lëvizshmëri e qëndrueshme për një mjedis cilësor urban. | 3 | Tiranë | 9 | 1,800,000 |
| 61 | 154 | Qendra 'Jean Jacque Rousseau' | Permiresimi i te drejtave te punemarresve ne kompanite e medha | 2 | Tiranë | 6 | 1,800,000 |
| 62 | 156 | Shoqata "Team-Together Everyone Achieves More" | Unë jam Europian | 4 | Tiranë | 6 | 1,700,000 |